

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO

Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
 Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
 Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo

ARKIV · ARHIV · ARCHIVE

Nr. Prot. 106  
 Br. Prot. - 3 -  
 Prot. no

Data: 08.02.2019  
 Datum  
 Date:

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo



OIK  
 Oda e infermiereve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
 The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Për: Z. Hashim Thaçi – President i Republikës së Kosovës

Nga: Z. Naser Rrustemi – Kryetar i OIK

Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë  
 Rr. Holger Petersen, 10000 Prishtinë  
 Republika e Kosovës  
 Tel: +383 900 900  
 Email: [info@oik-ks.org](mailto:info@oik-ks.org)



Ref: Kërkesë për kthimin në rishqyrtim të Ligjit për  
 Prishtinë: 08 Shkurt 2019

Pagat në Sektorin Publik

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 ZYRA E PRESIDENTIT - URED PREDSEDNIKA - OFFICE OF THE PRESIDENT

Nr. Prot.: 201  
 Br. Prot.:  
 Prot. No:

Data: 08 / 02 / 2019  
 Datum:  
 Date:

PRISHTINË/A

I nderuari zotëri President Thaçi,

Më datë 02 Shkurt 2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Pagat në Sektorin Publik.

Ky ligj thellon hendekun social në Republikën e Kosovës, është miratuar në një procedurë ligjore ku diskutimi publik i tij nuk ka qënë mjaftueshëm shtërrues me të gjithë palët e interesit madje shumë kategori nuk janë konsultuar fare. Për më tepër në ditët e fundit para aprovimit të tij ky ligj ishte shndërruar në pazare të caktuara politike dhe koeficient të caktuar brenda këtij ligji ishin ndryshuar para dhe gjatë seancës parlamentare për aprovimin e tij, pa bërë asnjë analizë mbi impaktin financiar që mund të ketë ky ligj e për më tepër pa analizuar fare efektet që mund të ketë karshi drejtësisë sociale në vendin tonë.

I nderuari zotëri President, me lejoni të ju informoj me statusin ligjor, aktivitetet, përgjegjësitë, objektivat dhe antaresinë e Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë.

Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë është e themeluar dhe rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve Shëndetësor. Sipas këtij ligji antarësimi në Odën e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë është obligative për infermierët e diplomuar, mamitë e diplomuara, profesionistët tjerë shëndetësor me

kualifikim të mesëm dhe të lartë të përcaktuar në regjistrin zyrtarë të Ministrisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Konform nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve Shëndetësor, Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë, përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve të Odës në ushtrimin e profesionit; bashkëpunon me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunon me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit, po ashtu përfaqëson interesat profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve tjerë; ofron konsultim, ndihmë dhe përfaqësim të interesave të anëtarëve në fushën e legjislacionit si dhe lëmive tjera që ndërlidhen me fushën e shëndetësisë.

Në përputhje me përgjegjësitë që burojnë nga Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve Shëndetësor, Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë iu drejtohet me kërkesën për kthim në rishqyrtim të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik për arsyet si në vijim:

Infermieret, Mamit dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të përfaqësuar nga kjo Odë, me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik janë kategorizuar në koeficientët me të ultë të mundshëm, madje lirisht mund të themi degradues e fyes. Për më tepër pa kurrfarë konsultimi paraprak më odën, janë kategorizuar të gjithë Infermieret, Mamit dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë en bloc në një koeficient të vetëm (koeficient 2.2) pa bërë kurrfarë analize dhe pa marr parasysh asnjë kriter bazik për këtë kategorizim. Për më tepër gjatë këtij kategorizimi en bloc brenda një koeficienti fare nuk është marr për bazë kriteri me bazik ai i shkollimit ku dihet që në mesin e këtyre profesionisteve ka të punësuar me gradën doktor, gradën master, bachelor etj. Pra të gjithë këta profesionist me gradat e specifikuar në këtë paragraf janë ranguar në të njëjtin koeficient (koeficient ky i barabartë me pagaditje shkollimi të mesëm).

Konsiderojmë se rangimi i këtyre profesionistëve do të duhej të bëhej përmes koeficientëve të përshkallëzuar dhe rangimi të bëhej konform shkollimit të tyre, gradës, eksperiencës në vendin e punës dhe kriterëve të njohura nga fusha e të drejtës së punës.

Shqetësimet e anëtarëve të Odës së bashku me kërkesën për unifikim të koeficientit bazuar në grada dhe pagaditje profesionale dhe propozimin e Odës mbi nivelet e koeficientëve, i kemi ngritur dhe adresuar edhe para aprovimit të ligjit në formë zyrtare, dhe atë më datë 09.11.2018 dhe 28.01.2019, iu kemi drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa; Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Komisionit për Administratë Publike, të Kuvendit të Republikës së Kosovës por që asnjëherë kërkesat e Odës dhe anëtarësisë se saj nuk janë marr parasysh.

Mbi bazën e argumenteve si më lartë konsiderojmë që me këtë ligj janë cenuara vlerat universale të cilat mbrohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e thekson qartë se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, **barazisë**, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, **mosdiskriminimit**, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, **drejtësisë sociale**, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Ky ligj cenon rëndë parimin e barazisë të cilin e promovon kushtetuta jonë, është diskriminues dhe nuk promovon parimet e drejtësisë sociale por thëllon hendekun social në vendin tonë. Ky ligj nuk promovon transparencë por perkundrazi është aprovuar në një procedurë të dyshimtë, me pazare politike ku grupe të interesit kanë akomoduar kërkesat e tyre ndërsa shumë prej profesionistëve kanë mbetur të përbuzur dhe të diskriminuar. Ky ligj cenon rëndë dispozitat dhe parimet bazë të Ligjit Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Rrjedhimisht, me anë të kësaj shkrese kërkojmë nga Presidenti i Republikës që në përputhje me Nenin 84 paragrafi 6 i Kushtetutës së Kosovës të përdor të drejtën për kthimi për rishqyrtim të ligjit për pagat në sektorin publik të miratuar në Kuvendin e Kosovës sepse ky ligj është i dëmshëm për interesat legjitime të Republikës së Kosovës.

Kthimi në rishqyrtim i ligjit për pagat në sektorin publik të miratuar në Kuvendin e Kosovës është i doemosdoshëm dhe do t'i hapte rrugë ri-fillimit të dialogut social në vend për adresimin e shqetësimeve të anëtarëve të odës tonë dhe sektorëve të tjerë të cilët kanë mbetur pa adresuar kërkesat e tyre. Plotësim ndryshimi i këtij ligji përmes një procesi të hapur dhe transparent i bazuar në konsultim të ngushtë me Odat dhe sindikatat përkatëse dhe hapja e dialogut social do të prodhonte efekte pozitive në vend dhe do të ishte në të mirë të interesave legjitime dhe afatgjata të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në të lartëshenuarat, mbesim me shpresë që kjo kërkesë e jona do të has në mirëkuptimin tuaj dhe ligji për paga në sektorin publik do të kthehet në rishqyrtim në Kuvendin e Kosovës.

Ju falemnderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Me respekt!  
Naser Rustemi  
Kryetar i OIK